

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Fillim Skoro, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti e Have Haliti, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Arta Dumani, si procesmbajtëse, në lëndën penale kunder të akuzuarve S.S. nga fshati ... – Komuna e Vitise për shkak të veprës penale mbajtja ne pronesi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 te KPRK-se, A.T. nga fshati ... – Komuna e Vitise per shkak te veprës penale Perdorimi i armes apo mjetit te rrezikshem nga neni 375 par.2 te KPRK-se, Z.K. nga fshati ... – Komuna e Suharekes per shkak te veprave penale mbajtja ne pronesi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 te KPRK-se dhe veprës penale lendimi i lehte trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nenpar 1.1 te KPRK-se, B.K. nga fshati ... – Komuna e Suharekes per shkak te veprës penale Sulmi nga neni 187 par.1 lidhur me nenin 31 te KPRK-se dhe Perparim Asllanaj nga fshati Pozhar – Komuna e Deqanit per shkak te veprës penale Sulmi nga neni 187 par.1 lidhur me nenin 31 te KPRK-se, duke vendosur sipas ankeses se Prokurorisë Themelore ne Gjilan, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan PKR.nr.90/15, të datës 21.04.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 14 gusht 2017, mori këtë ;

AKTGJYKIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ndersa, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan PKR.nr.90/15, i datës 21.04.2017 VERTETOHET.

Arsyetim

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Gjilan PKR.nr.90/15, të datës 21.04.2017, i akuzuari S.S. është shpallur fajtorë për shkak të veprës penale mbajtja ne pronesi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 te KPRK-se , për te cilen i është shqiptuar denimi me gjobe ne shume prej 500 (peseqind) Euro e te cilen gjobe është obliguar qe ta paguaje ne afat prej 15 ditesh nga dita e plotfuqishmerise se ketij aktgjykimi, ne te kunderten denimi me gjobe do te i zevendesohet me denim burgu duke llogaritur nga 20 euro per nje dite burgu. I akuzuari Z.K. është shpallur fajtorë për shkak të veprës penale mbajtja ne pronesi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 te KPRK-se , për te cilen i është shqiptuar denimi me gjobe ne shume prej 500 (peseqind) Euro e te cilen gjobe është obliguar qe ta paguaje ne afat prej 15 ditesh nga dita e plotfuqishmerise se ketij aktgjykimi, ne te kunderten denimi me gjobe do te i zevendesohet me denim burgu duke llogaritur nga 20 euro per nje dite burgu si dhe per veprën penale lendim i

lehte trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nenpar.1.1 te KPRK-se per te cilen i eshte shqiptuar denimi me burgim ne kohezgjatje prej prej 2 (dy) muaj e ne te cilin denim i llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim prej dates 18.05.2015 e deri me date 08.06.2015 ashtu qe pjesa e mbetur e denimit me burgim prej 39 ditesh i zevendesohet ne denim me gjobe ne shume prej 700 euro e me zbatimin e dispozitave per denimin unik per te dy veprat penale i shqiptohet denimi unik me gjobe ne shume prej 1200 (njemije e dyqind) Euro e te cilen gjobe i akuzuari eshte i obliguar qe ta paguaje 15 dite nga dita e plotfuqishmerise se ketij aktgjykimi e ne te kunderten denimi me gjobe do te i zevendesohet ne denim burgu duke llogaritur nga 20 (njezet) euro per nje dite burgu. Te akuzuarit Z.K. i eshte shqiptuar edhe denimi plotesues konfiskimi i armes se zjarre – pushkes automatike me nr. serik 680138. I akuzuari B.K. eshte shpallur fajtor per vepren penale Sulmi nga neni 187 par.1 lidhur me nenin 31 te KPRK-se per te cilen i eshte shqiptuar denimi me gjobe ne shume prej 400 (katerqind) euro te cilen gjobe i akuzuari do ta paguaje 15 dite nga dita e plotfuqishmerise se aktgjykimit, ne te kunderten denimi me gjobe do te i zevendesohet me denim burgu duke llogaritur nga 20 (njezet) euro per nje dite burgu.

Te akuzuarit S.S., Z.K. dhe B.K. jane obliguar qe te i paguajne shpenzimet e procedures penale qe dalin sipas llogarise perfundimtare te gjykates si dhe paushallin gjyqesor dhe ate secili veq e veq ne shume prej nga 30 Euro e te gjitha keto ne afat prej 15 ditesh pas plotfuqishmerise se aktgjykimit.

I akuzuari A.T. konform nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPRK-së, në mungesë të provave është liruar nga akuza për shkak të veprës penale perdorimi i armes apo mjetit te rrezikshem nga neni 375 par.2 te KPRK-se.

Per kete te akuzuar shpenzimet e procedures penale bien ne barre te mjeteve buxhetore te gjykates.

Kundër këtij aktgjykimi, ne afatin ligjor ka ushtruar ankesë Prokuroria Themelore në Gjilan, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për pjesën liruese të aktgjykimit lidhur me të akuzuarin A.T. me propozim që Gjykata e Apelit e Kosoves, aktgjykimin e ankimuar te gjykates se shkalles se pare në këtë pjesë ta anulojë dhe qështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë ne rigjykim dhe vendosje.

Përgjegje në ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit S.S. -av.Sh.I. i cili ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i kundërshtuar i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Prokurori i Apelit i Kosoves, duke u skjaruar përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore ne Gjilan me shkresën e vet PPA/I.nr.301/17, të datës 19.06.2017, ka propozuar që ankesa e PTH ne Gjilan te aprovohet si e bazuar.

Gjykata e Apelit, pasi i shqyrtoi te gjitha shkresat e qeshtjes penale, studioi aktgjykimin e ankimuar ne pajtim me dispoziten e nenit 394 par.1 te KPPK-se dhe pas vleresimit te pretendimeve te cekura ne ankesa gjeti se

-Ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan nuk eshte e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i gjykates se shkalles se pare ne raport me te akuzuarit S.S., Z.K. dhe B.K. nuk ankimohet per shkak te shkeljeve esenciale te dispozitave te procedures penale, megjithate Gjykata e Apelit e Kosoves te njejtin sipas detyres zyrtare e shqyrtoi edhe ne kete aspekt konform dispozites se nenit 384 te KPPRK-se dhe konstatoi se i njejti nuk permban shkelje esenciale te dispozitave te procedures penale dhe as shkelje te ligjit penal ne dem te akuzuarve e te cilat kishin me kushtezuar anulimin e tij.

Po ashtu as gjendja e fakteve ne raport me keta te akuzuar nuk ka qene objekt vleresimi i kesaj gjykate, ngase as me ankese nuk ka mundur te kontestohet sepse te akuzuarit e lartecekur ne shqyrtimin fillestar e kane pranuar fajesine per te gjitha pikat e akuzes dhe trupi gjykues si dhe prokuroria jane pajtuar me nje pohim te tille ngase te njejtit jane bere pas konsultimit me mbrojtetit e tyre dhe ka mbeshtetje ne provat te cilat gjenden ne shkresat e lendes.

Sa i perket pjeses liruese te aktgjykimit lidhur me te akuzuarin A.T. te cilin gjykata e shkalles se pare e ka liruar nga akuza ne mungese te provave per shkak te vepres Perdorimi i armes apo mjetit te rrezikshem nga neni 375 par.2 te KPRK-se, Prokuroria Themelore ne Gjilan kete pjese te aktgjykimit e atakon per shkak te shkeljeve esenciale te dispozitave te procedures penale duke konsideruar se i njejti aktgjykim permbane shkelje nga neni 384 par.1 nenpar.1.12 te KPPRK-se ngase lidhur me kete te akuzuar dispozitivi i aktgjykimit eshte i pakuptueshem dhe kunderthenes ne brendine e tij e sidomos fakti se arsyerat jane te paqarta dhe kunderthenie ne mes te asaj qe paraqitet ne arsyetimin lidhur me permbajtjen e shkresave dhe procesverbaleve per deklarimet e dhena.

Gjykata e Apelit e Kosoves gjeti se nuk jane te bazuara pretendimet ankimore lidhur me shkeljet esenciale te dispozitave te kodit te procedures penale lidhur me pjesen liruese te aktgjykimit lidhur me te akuzuarin A.T. ngase gjykata e shkalles se pare ka dhene arsye te mjaftueshme kur te njejtin e ka liruar nga akuza ne mungese te provave e ne baze te nenit 364 par.1 pika 1.3 te KPPRK-se ngase nga provat ne shkresat e lendes nuk eshte vertetuar se i njejti e ka kryer vepren penale perdorimi i armes apo mjetit te rrezikshem nga neni 375 par.2 te KPRK-se per te cilen ka qene i akuzuar.

Gjithashtu, Gjykata e Apelit gjen se nuk jane te bazuara pretendimet ankimore lidhur me vertetimin e gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike per pjesen liruese te aktgjykimit ngase gjykata e shkalles se pare me asnje prove nuk ka arritur qe ta vertetoje qe i akuzuari A.T. ta kete perdorur arme ne menyren siq akuzohet, ngase nga deshmia e deshmitarit H.B. dhe Sh.H. nuk eshte vertetuar se i akuzuari A.T. ta kete perdorur arme e zjarrit ne Kasino ne momentin kur te akuzuarit B.K., P.A. dhe Z.K. kane hyre ne Kasino, ngase deshmitaret e lartecekur kane deklaruar ne shqyrtimin gjyqesor se ne ate moment A.T. ka qene ne toalet dhe me pas nuk kane pare se qka ka ndodhur. Gjithashtu, edhe A.T. kategorikisht e ka mohuar se ka pasur arme ne dore e as qe ka perdore arme.

Pra, nga kjo del se ne veprimet e te akuzuarit A.T. nuk ekzistojne elementet e vepres penale per te cilen ka qene i akuzuar andaj edhe pretendimet e PTH ne Gjilan lidhur me vertetimin e gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike e as nuk ka shkelje te ligjit penal ne favor te akuzuarit.

Sipas vleresimit te Gjykates se Apelit te Kosoves, gjykata e shkalles se pare me rastin e shqiptimit te denimeve te akuzuarve i ka vleresuar te gjitha rrethanat lehtesuese dhe renduese nga neni 73 te KPRK-se e te cilat ndikojne ne llojin dhe lartesine e denimit dhe gjeti se denimet e shqiptuara te akuzuarve jane ne perpjestim me peshen e veprave penale te kryera. Prandaj, duke patur parasysh rrethanat e cekura me larte, rrethanat e rastit konkret, menyren e kryerjes se veprave penale kjo gjykate konsideron se denimet e shqiptuara te akuzuarve jane ne harmoni me intenzitetin e rrezikshmerise shoqerore te veprave penale dhe me shkallen e pergjegjesise penale te akuzuarve dhe se denimet e shqiptuara jane ne funksion te parandalimit te kryesve nga kryerja e veprave penale ne te ardhmen, te bej rehabilitimin e tyre si dhe te ndikojne edhe ne personat e tjere qe te mos kryejne vepra penale, duke konsideruar se me denimet e shqiptuara si ne dispozitiv te aktgjykimit te ankimuar do te arrihet qellimi i denimit i parapare me dispoziten e nenit 41 te KPRK-se.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të Kodit të Procedures Penale të Kosovës u vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.312/17, Më 14.08.2017

Procesmbajtëse
Arta Dumani

Anëtarët e kolegjit
Abdullah Ahmeti

Kryetari i kolegjit,
Fillim Skoro

Have Haliti
